

KONTRATË PËR BLERJE AKSIONËSH

Në Tiranë, sot më datën 06.04.2005 (dy mijë e pesë), në Dhomën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Buteko Collet, ndërmjet:

- a) **Panagiotis Bitros**, i biri i Ioannou dhe Archontias, biznesmen, lindur në Athinë, Attikis, Greqi, më 22.05.1935, banues në Ekali Attikis, Pindarou Str 1, Greqi, mbajtës i pasaportës greke Nr. O928791, (në vazhdim quajtur "Shitësi"), përfaqësuar këtu nga z. Andon Kokoli, mbajtës i pasaportës shqiptare Nr.0865688, në bazë të Prokurës Nr. 18.299/ 08.03.2005 të redaktuar nga Noteri Publik grek, znj. Anna Kallitsi - Panagopoulou - Kolokotroni 74-76, Pire.
- b) **Shoqërisë anonime "PIRAEUS BANK SA"**, shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve greke, me seli në Athinë (20 Amalias Avenue & 5, Souri Str.), regjistruar rregullisht në Regjistrin e Shoqërive Aksionere mbajtur nga Ministria e Tregtisë me Nr.6065/06/B/86/04 (në vazhdim quajtur "Blerësi"), përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. Dimitrios Fraggetis, shtetas grek, mbajtës i pasaportës greke Nr. O 253968, në bazë të Prokurës Nr. 6.392/17.02.2005 redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis – Kolokotroni 70, Pire.

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

- 1. Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të dymijë e treqind e pesëdhjetë e tetë (2.358) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili. Këto aksione përfaqësojnë 2,00% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të Liçensës së Veprimit Nr.07/12.09.1996 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Për këto aksione është lëshuar një certifikatë aksioni provizore (Nr.6, datë 13.10.2004).
- 2. Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të të gjitha aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të dymijë e treqind e pesëdhjetë e tetë (2.358) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili, që përfaqësojnë 2,00% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre, **Blerësit** i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë (389.070) EUR. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të BANKA e TIRANËS.
- 3. Blerësi** ia ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë (389.070) EUR.

4. **Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.

5. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.

6. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë dhe ai do të marrë nga BANKA e TIRANËS certifikatat përfundimtare të aksioneve kur ato të lëshohen.

7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.

8. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.


Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë ekzekutohet në katër origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, kopja e tretë mbahet nga Noteri Publik e kopja e katërt depozitohet në Regjistrin Tregtar, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë në prezencë të përkthyeses Violeta XHAMO lindur më 01.10.1969, lindur e banuese në Tiranë me pasaportë Nr.0063577 dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua regullisht prej tyre para Noterit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI


Panagiotis Bitros

Përfaqësuar me Prokurë nga



Përkthyesë:


Violeta Xhamo




BLERËSI

“PIRAEUS BANK SA”

Përfaqësuar me Prokurë nga



D. FRANGETIS



NOTERE
ERIKETA KOLLI